

XHAVIT SHALA

BALLKANI GJEOPOLITIKA DHE SIGURIA II



PARATHËNIE

I nderuar lexues!

Përfundimi i një libri, qoftë ai dhe i thjeshtë, është jo vetëm finalizim i një pune disavjeçare, por dhe kurorëzim i emocioneve të forta, që i kanë provuar vetëm ata të cilët kanë pasur kënaqësinë, fatin dhe privilegjin që, nëpërmjet botimeve, t'u vlerësohet puna prej të tjerëve. Shpresoj shumë dhe besoj në testin e së vërtetës, i cili për mua është opinionin dhe gjykimin juaj objektiv.

Kam vite që punoj dhe botoj shkrime, analiza, studime e libra në fushën e sigurisë kombëtare, të asaj rajonale e më gjerë. Nisur nga kjo kam ndjerë nevojën e një botimi të plotë në fushën e gjeopolitikës dhe sigurisë për Evropën Juglindore. Libri që keni në duar mendoj se është një çelës për të gjetur shpjegim jo vetëm i asaj që ka ndodhur në Ballkan, por dhe për ecurinë e problemeve e prognozatat për të ardhmen, të nxjerra këto mbi bazën e analizave shumëplanëshe.

Duke shfrytëzuar shumë burime, janë grumbulluar, studiuar dhe analizuar shumë fakte e prova, të cilat hedhin dritë mbi zhvillimet gjeopolitike dhe intrigat ballkanike, rolin e fuqive të mëdha e të faktorit të sotëm ndërkombëtar në këto zhvillime, pozicionin e shqiptarëve e të çështjes shqiptare në përgjithësi në këtë vorbull si dhe politikatat e sigurisë kombëtare për zgjidhjen e saj.

Libri që keni në duar shërben si tekst i plotë për studentët universitarë, të orientuar për shkencat politike, marrëdhëniet ndërkombëtare e studimet në fushën e sigurisë. Jam i bindur se ky libër gjithashtu do të shërbejë si një literaturë e nevojshme për këdo që kryen studime apo është i interesuar për dinamikën e zhvillimeve në rrafshin ballkanik.

Në aspektin didaktik botimi është i strukturuar në 17 krerë dhe sipas problematikave të caktuara është ndarë në dy pjesë. Ky strukturim është bërë jo vetëm për anën racionale të saj, por edhe për t'u ardhur më mirë në ndihmë lexuesve e studiuesve, të vendit e të huaj. Në formën që është paraqitur libri i përshtatet kërkesave të auditorit dhe të mësimdhënies.

Në kreun e parë jepen konceptet dhe bëhet trajtimi kuptimor dhe historik i gjeopolitikës, gjeostrategjisë dhe sigurisë, evoluimi dhe mendimet bashkëkohore rreth tyre. Më pas analizohen konfliktet ballkanike, gjeopolitika dhe siguria rajonale deri fund të luftës ftohtë. Në kreun e tretë analizohet procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë, krijimi i shteteve të pavarura dhe ndikimi në gjeopolitikën dhe mjedisin rajonal të sigurisë. Në një kre të veçantë analizohet kriza shqiptare e vitit 1997, shkaqet, faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që sollën atë si dhe pasojat për sigurinë kombëtare e atë rajonale.

Në kreun e pestë, të gjashtë dhe të shtatë të librit, lexuesit do të njihen më gjeopolitikën e shqiptarëve në rajonin e Ballkanit. Në mënyrë të veçantë trajtohet çështja kombëtare shqiptare dhe politikat e sigurisë kombëtare për zgjidhjen e saj. Analizohet çështja e Kosovës, duke filluar nga gjenocidi shekullor serb si metodë për ndryshimin e dhunshëm të gjeopolitikës shqiptare në Kosovë; ndërhyrja e Natos-s dhe administrimi ndërkombëtar i saj, krijimi i shtetit të pavarur të Kosovës, ndikimi në gjeopolitikën ballkanike dhe sfidat që e shoqërojnë atë. Gjithashtu këtu lexuesi do të njihet dhe me origjinën dhe dinamikën e konfliktit ndëretnik në Maqedoni, marrëveshja e Ohrit dhe sfidat për sigurinë rajonale.

Për nga roli që kanë luajtur në zhvillimet në Ballkan, por dhe për rëndësinë që aktualisht kanë për sigurinë rajonale e më gjërë, në kapituj të veçantë në libër analizohen dhe trajtohen çështjet fetare në Ballkan dhe ndikimi i tyre në sigurinë rajonale; çështja e minoriteteve në Ballkan, liria, siguria dhe domosdoshmëria e respektimit të tyre; terrorizmi ndërkombëtar dhe ndikimi i tij në gjeopolitikën dhe sigurinë rajonale; krimi i organizuar si lojtar me përvojë në gjeopolitikën rajonale e kërcënim për sigurinë kombëtare e atë rajonale.

Në krerë të veçantë në këtë libër argumentohet se shërimi i plagëve ballkanike do të bëhet vetëm nëpërmjet proceseve integruese euroatlantike, pranimin e shteteve të rajonit në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Në mënyrë të veçantë këtu trajtohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërtimi i masave të përbashkëta të sigurisë si vizion i ri i sigurisë në Evropën Juglindore; bashkëpunimi ndërkufitar, menaxhimi i integruar i kufijve dhe ndikimi i tyre në gjeopolitikën dhe sigurinë rajonale; Ballkani dhe integrimi në nato e BE, perspektiva dhe sfidat për sigurinë.

Në një tjetër kre në libër analizohet roli i Rosisë, raportet dhe ndikimi i saj në gjeopolitikën dhe sigurinë rajonale. Përveç sa më sipër, në këtë libër lexuesi do të gjejë të trajtuar e analizuar edhe mjaft çështje tjera të lidhura me gjeopolitikën dhe sigurinë tonë kombëtare, sigurinë rajonale e më gjerë.

Ndjehem thellësisht i detyruar të falënderoj të gjithë ata studiues, miq, shokë e kolegë të mi si Fredi, Iliri, Krenari, Bujari, Prof. Ismeti, Prof. Vasillaqi, etj., me të cilët jam këshilluar dhe të cilët më kanë inkurajuar në finalizimin e këtij libri. Nuk mund të rri pa përmendur këtu edhe kontributin e redaktorit të librit zotit Nexhat Myftiu si dhe të bashkëshortes sime Aidës, e cila është lexuesja, oponentja dhe redaktorja e parë e dorëshkrimeve të këtij libri.

Autori.

PJESA II

KREU X

ÇËSHJET FETARE NË BALLKAN DHE NDIKIMI NE SIGURINË RAJONALE

- X.1. Besimet fetare dhe roli i tyre në zhvillimet gjeopolitike dhe në çështjet e sigurisë.
- X.2. Dinamika e besimeve fetare në rajonin e Ballkanit.
- X.3. Pushtimi i Ballkanit nga Perandoria Osmane dhe përhapja e fesë islame.
- X.4. Raporti i kishave ortodokse dhe katolike me shtetin osman.
- X.5. Konvertimi i dhunshëm në fenë ortodokse i popullsisë shqiptare.
- X.6. Rrymat ekstremiste fetare dhe siguria rajonale.
- X.7. Çështjet fetare në hapësirat shqiptare dhe siguria jonë kombëtare

KREU XI

LIRIA, SIGURIA DHE DOMOSDOSHMËRIA E RESPEKTIMIT TË MINORITETEVE NË BALLKAN

- XI.1. Etimologjia dhe kuptimi mbi minoritetet etnike.
- XI.2. Të drejtat dhe liritë e minoriteteve dhe siguria rajonale.
- XI.3. Minoritetet ne Ballkan dhe veçoritë historike të krijimit te tyre.
- XI.4. Shqipëria dhe çështja e minoriteteve.
- XI.5. Greqia dhe minoritetet e mohuara etnike.
- XI.6. Mali i Zi, minoriteti shqiptar dhe çështjet e sigurisë.
- XI.7. Kosova, projekti pilot ndërkombëtar dhe përfaqësimi i minoriteteve në flamurin shtetëror.
- XI.8. Serbia dhe dilema për respektimin e minoriteteve.
- XI.9. Bosnja dhe garantimi ushtarak i minoriteteve në kufijtë etnikë
- XI.10. Kroacia dhe grupi etnik serb në territorin e saj.
- XI.11. Rumania dhe grupi etnik hungarez.
- XI.12. Bullgaria, grupet kryesore etnike në territorin e saj dhe çështjet e sigurisë.

KREU XII

TERRORIZMI NDËRKOMBËTAR DHE NDIKIMIMI I TIJ NË GJEOPOLITIKËN DHE NË SIGURINE RAJONALE

- XII.1. Kuptimi mbi terrorizmin dhe terrorizmi ndërkombëtar
- XII.2. Klasifikimi i terrorizmit
- XII.3. Faktorët dhe shkaqet që ndikojnë në fenomenin e terrorizmit
- XII.4. Terrorizmi modern, tendencat dhe kërcënimet në rritje për sigurinë
- XII.5. Terrorizmi, gjeopolitika dhe siguria
- XII. 6. Ballkani dhe kërcënimi terrorist

KREU XIII

KRIMI I ORGANIZUAR, KËRCENIM PËR GJEOPOLITIKËN DHE SIGURINË NË EUROPËN JUGLINDORE

- XIII.1. Kuptimi për krimin e organizuar në Europën Juglindore
- XIII.2. Karakteristikat e krimit të organizuar ballkanik.
- XIII.3. Disa veçori të grupeve shqiptare të krimit të organizuar
- XIII.4. Faktorët që mundësuan përhapjen e shpejtë të krimit të organizuar
- XIII.5. Krimi i organizuar, lojtar me përvojë në gjeopolitikën rajonale
- XIII.6. Krimi i organizuar kërcënim për sigurinë kombëtare e rajonale
- XIII.7. Bashkëpunimi rajonal, domosdoshmëri në luftën kundër krimit të organizuar

KREU XIV

BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR, MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIJVE, GJEOPOLITIKA DHE SIGURIA RAJONALE

- XIV.1. Kufijtë, gjeopolitika dhe gjeostrategjia
- XIV.2. Koncepti mbi menaxhimin e integruar të kufijve
- XIV.3. Menaxhimi i integruar i kufijve, siguria dhe integrimi euroatlantik

KREU XV

BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE NDËRTIMI I MASAVE TË PËRBASHKËTA TË SIGURISË - VIZIONI I RI I SIGURISË

- XV.1. Ballkani mes së shkuarës konfliktuale dhe domosdoshmërisë së bashkëpunimit rajonal
- XV.2. Prioritetet dhe nismat kryesore të bashkëpunimit rajonal
- XV.3. Fushat kryesore të bashkëpunimit në Europën Juglindore
- XV.4. Masat e përbashkëta të sigurisë rajonale - vizioni i ri i sigurisë

KREU XVI

BALLKANI DHE INTEGRIMI NË NATO, FAZAT, PERSPEKTIVA DHE SFIDAT PËR SIGURINË RAJONALE

- XVI.1. Aleanca e Atlantikut të Veriut (NATO) dhe detyra themelore në fushën e sigurisë kolektive.
- XVI.2. Dinamika e konceptit strategjik të NATO-s që nga themelimi i saj
- XVI.2. NATO-ja, Europa Juglindore dhe sfidat e sigurisë rajonale
- XVI.3. Shqipëria dhe integrimi në NATO. Fazat dhe ndikimet për sigurinë

KREU XVII

INTEGRIMI I BALLKANIT NË BE, FAZAT, PERSPEKTIVA DHE SFIDAT PËR SIGURINË E EUROPËS JUGLINDORE

- XVII.1. Bashkimi European si organizim i ri gjeopolitik i Europës së pas luftës
- XVII.2. Bashkimi European dhe politikat e sigurisë së përbashkët
- XVII.3. Integrimi i Ballkanit në BE, domosdoshmëria, perspektiva, fazat dhe sfida për sigurinë.
- XVII.4. Integrimi i Shqipërisë në BE, perspektivat dhe sfidat.